



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM

Nr 125 Datë 27.11.08

**Për miratimin e fondit prej 400 000 lekësh për ngritjen e Obeliskut
“ABC” në kodrën ku u mbajt Mitingu i Shkronjave në1910**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët “Për miratimin e fondit prej 400 000 lekësh për ngritjen e Obeliskut “ABC” në kodrën ku u mbajt Mitingu i Shkronjave në1910”, Ne zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32 pika “dh”, ligjit nr 8399 dt. 09.09.2008 “Për buxhetin lokal”, Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2008”, Udhëzimit nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008”, Udhëzimit nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrisë së Brendshme “Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008”, Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit total prej 400 000 lekë për ngritjen e Obeliskut “ABC” në kodrën ku u mbajt Mitingu i Shkronjave në1910

2. Ky fond do të perballohet me shumën prej 400 000 lekësh nga fondi i planifikuar i pagave në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2008 të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00	01110	05	Art	6000000	- 400.000 (Bashkia)
-----------	----	-------	----	-----	---------	---------------------

Shtohet	00	08250	05	Art	2310000	+ 400.000 (Q. Ek e Kulturës “V. Mio”)
---------	----	-------	----	-----	---------	---------------------------------------

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët, Qendra Ekonomike e Kultures “V. Mio” dhe Drejtoria e Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Raimonda NASE
Raimonda NASE